

 Republika e Kosovës Republika Kosova Republic of Kosovo	DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	NR.: 470/2021	DATË: 06-09.2021	

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), në nenin 14,15,19,20, 21 të Ligjit Nr.04/ L-110 të Ndërtimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.18/2012), të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), shqyrtoj kërkesën Nr.11-351-23755 të datës 28.06.2021 të parashtruar nga investori/pronari ISA (KADRI) ARIFAJ, për lëshimin e Lejes Ndërtimore për Ndërtimin e Murit Rrethues bazuar në PZHK të Istogut, dhe bazuar në Rekomandimin Nr.11/110/2021 të datës 26.08.2021 të hartuar nga Grupi Punues i Ekspertëve i propozon Kryetarit të nxjerr:

VENDIM

(PËR LEJE NDËRTIMORE PËR NDËRTIMIN E MURIT RRETHUES)

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri	ISA (KADRI) ARIFAJ		
Adresa	Rruga "Fadil Ferati" nr. 118, Istog		
Tel,		E-mail:	

Emri i projektit:	NDËRTIMI I MURIT RRETHUES		
Emrat e projektuesve:	1. Faza e arkitekturës: Ida. Drilon JUSUFI, BArch. Faton BLAKAJ		
Kompania projektuese:	Studio Projektuese "ARCH-ART", Istog		
Tel.:		E-mail:	

Për punët ndërtimore në vijim:		
Vendndërtimi: 01730-4 ZK Istog		
Adresa e ndërtimit: Rruga "Fadil Ferati" nr. 118, Istog		
Zona(t) kadastrale ZK Istog	Numri i parcelës kadastrale: P-70806020-01730-4	GPS Koordinatat: x: y:

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtim i ri <input checked="" type="checkbox"/>	Rindërtim <input type="checkbox"/> Riparim <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I <input checked="" type="checkbox"/>	Kategoria II <input type="checkbox"/>
Përdorimi i propozuar:	A përfshinë kërkesa ndryshim të destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Përshkrimi: Leje për ndërtimin e Rrethojës së parcelës në pronën me numer të parcelës kadastrale: 01730-4 ZK Istog	

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore: ISA (KADRI) ARIFAJ i lejohet ndërtimi sipas dokumentacionit ndërtimor – projektit ideor dhe kryesor për ndërtim dhe atë sipas kushteve në vijim:

- Vija rregulluese e larguar nga vija kufizuese e parcelës – 0.10m.
- Përgjatë bijës kufizuese të parkut të jetë 11.0 m nga rruga kryesore.
- Lartësia e themeli mesatarisht. $h=0.30$, kurse rrethoja mbi tthemel të jetë deri në 1.20m.
- Rrethoja të punohet me rrjetë të zinguar në harmoni me parkun.

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelën informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informatat mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - protokollet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzoj njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;

- Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

ARSYETIM

Aplikuesi ISA (KADRI) ARIFAJ në cilësinë e investitorit ka kërkuar nga organi kompetent Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis me kërkesë me nr.**11-016-23755** të datës: 28-06-2021 lëshimin e Lejes Ndërtimore për **NDËRTIMIN E RRETHOJËS**: në parcelën me nr. **01730-4 ZK Istog** në lokacionin e përshkruar në paragrafin 1 të dispozitivit të **Lejes Ndërtimore**.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr.05/L-031 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për **Lëshimin e Lejes Ndërtimore**, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo **Leje Ndërtimore** bazohet në shqyrtimin e provave:

- Dëshmi të pronësisë dhe dokumentacioni personal i fotokopjuar
- Kushtet Ndërtimore – N/A
- Vendimi për Pëlqim Mjedisor - (Nuk Aplikohet)
- Pëlqim për mbrojtje nga zjarri – (N/A)
- Elaborati Gjeomekanik (N/A)
- Tri kopje të projektit ideor dhe kopje elektronike - për Kategorinë e I-rë – Ka prezantuar
- Dëshmi mbi zotimin e mjeteve për pagesën e taksave – Ka prezantuar
- Te tjera

Shtojcë: Lejes së ndërtimit i bashkëngjitet: situacioni i ngushtë.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim, përmes kësaj drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet: MMPHI-së në Prishtinë Brenda afatit prej 15 ditësh. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet tek organi epror kompetent, MMPHI.

Nga një kopje të këtij vendimi t'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës, investitorit
2. Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis
3. Drejtorisë së Inspeksionit
4. Drejtorisë së Kadastrit
5. Drejtorisë së Financave
6. Arkivës së Komunës

Zyrtarja ligjore



Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës

Haki RUGOVA